



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E LARTË

Nr.5240 prot.

Tiranë më 24.10. 2024

NJOFTIM

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË NIVEL DREJTUES

Bazuar në nenet 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të ligjit nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur ", vendimit nr.17, datë 19.09.2024 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Lartë shpall procedurën e "Lëvizjes paralele, të ngritjes në detyrë dhe atë të pranimit në shërbimin civil gjyqësor", për kategorinë e ulët drejtuese, për pozicionin:

I. 1 (një) pozicion – "Përgjegjës sektori", Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, **kategoria e pagës III-1. (nivel i ulët drejtues)**

Pozicioni u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori për procedurën e "Lëvizjes paralele". Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së "Ngritjes në detyrë". Nëse edhe pas përfundimit të kësaj procedure vendi rezulton vakant atëhere do vijohet me procedurën e "Pranimit në shërbimin civil gjyqësor në nivel drejtues".

Për procedurat (Lëvizje paralele , Ngritje në detyrë dhe Pranim në shërbimin civil gjyqësor në nivel drejtues) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

07 nëntor 2024

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

Afati i dorëzimit të dokumenteve për

Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe detyrat për pozicionin “Përgjegjës sektori” sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, është:

- Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse varet nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në GJL, merr detyra dhe përgjegjësi përpara tij për veprimtarinë e sektorit si dhe kryen çdo detyrë tjetër brenda fushës së tij të përgjegjësisë;
- Organizon punën sipas nevojave të identifikuar më parë nga specialisti i shërbimeve dhe merr masat për t'i plotësuar personelit të gjykatës kërkesat për materiale të nevojshme kancelarike dhe çdo pajisje tjetër;
- Organizon punën e specialistëve dhe punonjësve nën përgjegjësinë e tij/saj sipas detyrave që rrjedhin nga kuadri ligjor, si dhe sipas detyrave e udhëzimeve të caktuara nga Drejtori i Drejtorisë, Kancelari dhe Kryetari i Gjykatës;
- Bashkërendon punën për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike, duke analizuar kërkesat dhe nevojat e institucionit për punë, mallra dhe shërbime;
- Koordinon realizimin e procedurave të prokurimit publik në bashkëpunim me specialistin e prokurimeve me burim financimi nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me prokurimin publik, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit, mirëpërdorimin e fondeve publike në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Administrimit Buxhetor dhe Menaxhimin Financiar;
- Është përgjegjës për kryerjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në përputhje me parashikimet e regjistrit të prokurimeve publike dhe të legjislacionit të prokurimit publik;
- Përgjegjësi për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të mirëmbajtjes së godinës dhe transportit. Mbikëqyr magazinën dhe siguron zbatimin e rregullave të marrjes në dorëzim të vlerave materiale dhe dokumentimin e daljes së tyre nga magazine;
- Raporton tek Drejtori i Drejtorisë në lidhje me realizimin ose jo të detyrave/programit të punës duke dhënë shpjegimet përkatëse si dhe duke nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse në rast mosrealizimi;
- Konfirmon dhe mbikëqyr lëvizjet e shoferëve në varësi, kontrollon fletë-udhëtimet dhe lëvizjet e tyre sipas parashikimeve në aktet nënligjore, në bashkëpunim me specialistin e shërbimeve. Kontrollon përdorimin me korrektësi të mjeteve, pajisjeve dhe automjeteve, si dhe ndalon çdo keqpërdorim e shfrytëzim abuziv të tyre;

- Mbikëqyr procedurat për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, të pajisjeve dhe aparaturave, dhe kur konstatohet se dëmtimet e tyre kryhen me faj, nxjerr përgjegjësinë personale dhe parashtron propozimet për zhdëmtim;
- Kujdeset, koordinon dhe mbikëqyr punën për plotësimin e kërkesave për karburant e pjesë këmbimi të automjeteve të institucionit dhe siguron gatishmërinë e mjeteve, kujdeset për kryerjen e punimeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe të zyrave, për sigurimin me energji elektrike dhe lidhje telefonike, si dhe për krijimin e lehtësirave të nevojshme për veprimtarinë e gjykatës;
- Merr detyra dhe përgjegjësi përpara tij për veprimtarinë e sektorit si dhe kryen çdo detyrë tjetër brenda fushës së tij të përgjegjësisë;
- Përgatit materiale apo shkresa të ardhura në institucion apo ato të cilat u drejtohen të tretëve sipas porosive të eprorëve;
- Trajton çështje që kanë të bëjnë me shërbimet mbështetëse të Gjykatës;
- Punon brenda procedurave dhe orientimeve të përcaktuara nga kancelari dhe/ose Këshilli i Gjykatës.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor. (*kategoria III-1, nivel i ulët drejtues*)

1.1 Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe Kriteret e Veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për *Lëvizjen Paralele* si vijon:

- a) të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon, kategoria – III 1 (*dokument nga institucioni*);
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” ose “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat inxhinierike, profili ndërtim ose mekanik ose profesioneve të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë përvojë jo më pak se **5 (pesë)** vite pune si përgjegjës shërbimesh në gjykata
- Preferohen:

- specializime në fushën e administratës publike;
- aftësi menaxheriale si dhe aftësi për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar përdorimin e burimeve;
- aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse;
- aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
- të kenë njohuri të mira të përdorimit të programeve kompjuterike;
- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

1.2 Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Lartë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin që konkurren;
- Jetëshkrim i plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-i-standard>
- Fotokopje të noterizuar të diplomës; për diplomat jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Formular vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësim i fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Akt deklarimi lidhur me statusin e nëpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë; vlerësimet pozitive, apo të tjera, të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;
- Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Për procedurën ***Lëvizje Paralele*** kandidati duhet të paraqesë dorazi dokumentet brenda datës **07 nëntor 2024**, në ambientet e Gjykatës së Lartë, rruga “Ibrahim Rugova” nr.20, Tiranë ose përmes shërbimit postar në të njëjtën adresë.

1.3 Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak

Brenda datës **11.11.2024** Kancelari do të shpallë në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al, dhe të GJL, www.gjykataelartë.al listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, vendin, datën dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind)

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve sipas kësaj procedure do ta gjeni në udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”

Intervistës me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së email-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e skualifikuar paraqitet në Gjykatë brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.4 Fusha e Njohurive, Aftësitë dhe Cilësitë mbi të Cilat do të Zhvillohet Intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
3. Njohuritë mbi ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
4. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
5. Njohuritë mbi vendimin nr. 874, datë 29.09.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
6. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar

7. Njohuri të përgjithshme mbi ligjet specifike që kanë lidhje me përvojën profesionale

1.5 Mënyra e Vlerësimit të Kandidatit

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
2. Përvojën e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

1.6 Data e Daljes së Rezultateve të Konkurrimit dhe Mënyra e Komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Kancelari njofton individualisht me email kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre.

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin.

Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin e kandidatit më me shumë pikë, nga lista e hartuar.

Këshilli, ku emërohet nëpunësi civil gjyqësor i ri, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele, njofton KLGJ-në për rezultatet e procedurës.

Njoftimi me emrat e nëpunësve fitues shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të Gjykatës.

Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ-në, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

II. NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (*Lëvizje paralele dhe Ngritje në detyrë*) aplikohet në të njëjtën kohë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për procedurën e ngritjes në detyrë si vijon:

- të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar i një kategorie më të ulët për të cilën aplikon (*dokument nga institucioni*);
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” ose “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor”, (*ose të barasvlefshëm me të sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë*) në Shkencat inxhinierike, profili ndërtim ose mekanik ose në fusha të tjera të përshtashme me përshkrimin e punës. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë përvojë pune jo më pak **se 5 (pesë)** vjet si inxhinier ndërtimi ose inxhinier mekanik ose profesioneve të përshtatshme me përshkrimin e punës, në institucionet e sistemit gjyqësor.
- Preferohen specializime në fushën e administratës publike apo të menaxhimit; aftësi për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.
- Njohuri të mira të përdorimit të programeve kompjuterike.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

II.1 Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Lartë brenda dates **14.11.2024** dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin që konkurren;
- Jetëshkrim i plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-i-standard>
- Fotokopje të noterizuar të diplomës; për diplomat jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Formular vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësim i fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Akt deklarimi lidhur me statusin e nëpunësit civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, apo të tjera, të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;
- Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

II-2 Rezultatet për Fazën e Verifikimit Paraprak

Brenda datës **18.11.2024**, do të shpallet në faqen e internetit të GJL dhe KLGJ-së, lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi.

Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind)

Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve sipas kësaj procedure do ta gjeni në udhëzimin nr.85 , datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”

Intervista me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga institucioni ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

II-3 Fushat e Njohurive, Aftësitë dhe Cilësitë mbi të Cilat do të Zhvillohet Testimi

1. Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
3. Njohuritë mbi ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
4. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
5. Njohuritë mbi vendimin nr. 874, datë 29.09.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e

dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;

6. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar
7. Njohuri të përgjithshme mbi ligjet specifike që kanë lidhje me përvojën profesionale.
8. Vendim nr. 622, datë 10.12.2020 ” Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

II-4 Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen si më poshtë:

Vlerësimi i kandidatëve përfshin

- a. 70 (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës, përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse,
- b. 30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Këshilli i Gjykatës për intervistën e strukturuar me gojë, harton një sërë pyetjesh, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët. Përmbajtja e pyetjeve të intervistës me gojë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet në faqen zyrtare të Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht, në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së email-it, për rezultatet.

III- PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË NIVEL DREJTUES

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor në nivel drejtues.

Kriteret e përgjithshme për konkurrimin sipas kësaj procedure janë :

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit

Kandidatët duhet të plotësonë **kriteret e veçanta** si më poshtë:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” (*ose të barasvlefshëm me të sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë*), në Shkencat inxhinierike, profili ndërtim ose mekanik ose në fusha të tjera të përsjtatshme me përshkrimin e punës ,;. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Preferohen specializime në fushën e administratës publike apo të menaxhimit; aftësi për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.
- Njohuri të mira të përdorimit të programeve kompjuterike.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale sipas përshkrimit të punës që lidhet me gjykatën.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Lartë brenda datës **21.11.2024** dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim për vendin që konkurron;
- Jetëshkrim i plotësuar (CV) në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrim-i-standard> Fotokopje të noterizuar të diplomës; për diplomat jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Formular vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësim i fundit nga eprori direkt;

- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, apo të tjera, të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;
- Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë ku banon, që nuk ka çështje në ngarkim të tij/saj;
- Vërtetim banimi.
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

III-1 Fushat e Njohurive, Aftësitë dhe Cilësitë mbi të Cilat do të Zhvillohet Testimi

1. Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Njohuritë mbi ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
3. Njohuritë mbi ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
4. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
5. Njohuritë mbi vendimin nr. 874, datë 29.09.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
6. Njohuritë mbi udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar
7. Njohuri të përgjithshme mbi ligjet specifike që kanë lidhje me përvojën profesionale.
8. Vendim nr. 622, datë 10.12.2020 ” Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

III-2 Mënyra e Vlerësimit të Kandidatëve

Verifikimi paraprak bëhet nga Kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i Pranimit dhe Këshilli i Gjykatës. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **60** (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. **40** (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- a. për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- b. datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi (*testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë*)

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA E LARTË

Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20, 1001 Tiranë